



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:062134

Datë: 20.01.2021

Numri i dokumentit: 01426663

P.nr.1021/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Sabit Sadikaj në çështjen penale kundër të pandehurit S. B., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185, par.1, nën.par.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës me kërkesë për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1039/20, të datës 02.06.2020, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës, me datë 11.01.2021, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1039/20 të datës 02.06.2020, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

S.B., i biri i A., i lindur me datën, në M., me vendbanim të përkohshëm në kampin e azilantëve në V., me nr. Të ID nga Qendra e Azilit, marokien, shtetas i Republikës së M..

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se me datë 19.02.2020, rreth orës 23:05, në Prishtinë, saktësisht në Rr. "...", në kafiterinë "S.", i pandehuri për shkak të mosmarrëveshjeve të çastit me të dëmtuarin I.A., punëtor i sigurimit në lokal, me dashje që t'i shkaktojë lëndime trupore e ka sulmuar duke e goditur në hundë, e pastaj ka ikur nga vendi i ngjarjes, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkakuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

- me këtë ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 185, par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 4; 7; 17; 21; 41; 43; 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **njëqind euro (100.00€)**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar, i pandehuri mund ta paguaj deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurës penale aq sa do të llogaritet sipas shpenzim orës përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej njëzet euro (20.00€), si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumë 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1039/20, të datës 02.06.2020, ka akuzuar S.B., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185, par.1, nën.par.1.4 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar e që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjyqtari i çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës të tilla si: Raporti i Oficerëve Policor, i datës 20.02.2020; Raporti Informues, i datës 20.02.2020; Mendimi dhe Konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. N. U., i datës 01.06.2020, përkitazi me dëmtimet trupore të të dëmtuarit I. A., fotot, deklaratat si dhe informacionet tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.1021/20, të dt.11.01.2021

Gjyqtari,
Sabit Sadikaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi - urdhri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, në këtë gjykatë.